



na 28.08.2017

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI PENAL, gjyqtari Adem Shabani, procesmbajtës-praktikant [REDACTED] në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDACTED] nga fshati [REDACTED], komuna e [REDACTED] i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.810-6/15 të dt.25.11.2015, për shkak të veprës penale vjedhje pylli nga neni 358 par.1 të të KPRK-së, ku gjykata në të njëjtën çështje penale kishte vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj për dhënien e urdhrin ndëshkimor pa mbajtje të seancës gjyqësore, ka aprovuar kërkesën e prokurorisë, por i akuzuari në afatin ligjo ka parashtruar kundërshtim, për këtë gjykata ka caktuar shqyrtim gjyqësor dhe pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor në prani të përfaqësuesit të akuzës-prokurorit të shtetit Avdullah Abedini dhe të akuzuarit, me dt. 08.08.2017 solli dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna [REDACTED] i lindur me dt. [REDACTED] në të njëjtin vend, nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED] shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën fillore, i martuar baba i tre fëmijëve i pa punë, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTORE

Sepse me dt.14.05.2015 rreth orës 13:30 në pyllin shoqëror të cilin e menaxhon Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural-Sektori i Pylltarisë në Ferizaj, në rajonin ekonomiko-pyjor Neredime-Jezere, në vendin e quajtur "Pleshinë" me qëllim vjedhje me sharrë motorike ka prerë 2 copë dru të llojit ahui, me dimensione, të gjata 25 m, diametër 42-54cm, gjithsej në kubaturë prej 3,07 m/kub. të cilat i ka transportuar me traktor të tipit Ford, ku vlera e dëmit të shkaktuar është 413,00 €.

- Me të cilën kreu veprën penale vjedhje pyllit nga nen.358 par.1 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të neneve 4, 7, 41, 46, dhe 73 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPK-së të akuzuarin e

G J Y K O N
ME DËNIM ME GJOBË

Të akuzuarit [REDAKTUAR] i shqipton dënimin me gjobë në shumë prej 150 /njëqind e pesëdhjetë/ Euro, të cilin dënim me gjobë është i obliguar ta paguan me këste për një periudhë prej tre muajsh, konform nenit 46 par.2 të KPRK-së, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në raste se personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguan dënimin në të holla, sipas nenit 46 par.3 të KPK-së, i njëjti dënim do t'i shndërrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet një (1) ditë burgim.

E dëmtuar- përfaqësuesi i DBPZHR—Ferizaj për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i pandehuri që të paguaj paushallin gjyqësor shumë prej 20 €, në afat prej 30 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.810-6/15 të dt.25.11.2015 , për veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par.1 të KPK-së, dhe të njëjtën ditë ka parashtruar kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimor kundër të akuzuarit me arsyen se ka prova të besueshme që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i njëjti.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor, në vështrim të nenit 414 të KPPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor dhe me dt.28.04.2016, ka sjellë aktgjykim me urdhër ndëshkimor.

I akuzuari në afatin ligjor kundër aktgjykimit me urdhër ndëshkimor ka sjell kundërshtim dhe ka kërkuar nga gjykata që ta aprovoj si të bazuar dhe të caktoj shqyrtim gjyqësor dhe të thërret të gjitha palët e propozuara nga prokuroria e shtetit për ti prezantuar arsyet e ushtrimit të kundërshtimit.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor me dt. 08.08.2017 ka caktuar shqyrtimin gjyqësor ku ka ftuar të akuzuarin të përcjellë me vëmendje zbatimin e shqyrtimit gjyqësor duke e udhëzuar në kuptim të nenit 323 parag.2.1, 2.2 dhe 2.3 të KPPK-së.

Prokurori i shtetit Vavdullah Abedini ka lexuar aktakuzën të akuzuarit dhe pas leximit gjyqtari është bindur se i akuzuari e ka kuptuar në tërësi akuzën për të cilën është akuzuar dhe të njëjtit i ka dhënë mundësi të deklarohet mbi fajësinë apo pafajësinë e tij lidhur me veprën për të cilën është akuzuar.

Përkitazi me këtë i akuzuari A [REDAKTUAR] ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet por kundër Urdhërit Ndëshkimor ka bërë kundërshtim pasi është i gjendjes jo të mirë ekonomike dhe për këtë shkak kishte shkuar në shtetin Suedez që të punoj por nuk ka mundur të punësohet dhe tani është kthyer dhe se kjo ka qenë arsyeja që nuk është paraqitur me kohë në gjykata, gjithashtu llogaritja e dëmit të shkaktuar të dëmtuarës është vlerësim jo real dhe i propozon gjykatës që mos ta aprovon si të bazuar, tani është i martuar baba i dy fëmijëve i propozon gjykatës që me rastin e shqiptimit të dënimit të marrë për bazë rrethana lehtësuese.

Pas kësaj gjyqtari në shqyrtimin gjyqësor pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit ka vlerësuar se janë përmbushur kërkesat nga neni 326 par.4 i KPPK-së, pasi që i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, fajin e ka pranuar vullnetarisht duke e mbështetur në provat dhe materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit të cilat gjinden në shkresat e kësaj lënde penale dhe shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve konform nenit 352 të KPPK-së.

Në fjalën përfundimtare prokurori i shtetit Avdullah Abedini ka mbetur në tërësi pran aktakuzës së ngritur nga ana e prokurorisë si dhe kualifikimit juridik për veprën penale

e cila i vihet në barrë të akuzuarit, nga baza e pranimit të fajësisë nga ana e tij i cili pranin gjenë mbështetje të plotë edhe në provat tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës i ka propozuar gjykatës që të njëjtin ta shpallë fajtorë dhe ti shqiptoi sanksion penal të paraparë me ligj përmes të cilit do të arrihet qëllimi ndëshkimor, ndërsa me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit si rrethana lehtësuese të akuzuarit ti merr pranimin e fajësisë nga ana e tij gjendjen ekonomike që e përshkoi gjatë mbrojtjes së dhënë dhe premtimet se në të ardhmen nuk do të përsëris veprime të tilla.

I akuzuari [REDAKTUAR] në fjalën përfundimtare ka mbetur pran asaj se e ndien veten fajtorë dhe ka kërkuar nga gjykata që ti shqiptoj sanksion penal më të butë pasi është i gjendjes së varfër ekonomike dhe nuk është duke punuar askund.

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor konstatoi se i akuzuari pranimin e fajësisë e ka mbështet në provat që gjenden në shkresat e kësaj lënde prandaj vlerësuar nga aspekti juridik gjykata vërtetoi se i akuzuari ka kryer veprën penale vjedhje pyllit nga nen.358 par.1 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit nenit 73 të KPPK-së, si rrethana lehtësuese gjykata mori pranimin e fajësisë, i pa punë, si dhe rrethanat e tij familjare, se është i gjendjes jo të mirë ekonomike, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti. Në bazë të këtyre rrethanave gjykata i caktoj dënim si në dispozitiv të aktgjykimit, i shqipton dënimin me gjobë në shumë prej 150 /njëqind e pesëdhjetë/ Euro, të cilin dënim me gjobë është i obliguar ta paguan me këste për një periudhë prej tre muajsh, duke qenë e bindur se një dënim i tillë është plotësisht i justifikueshëm dhe në proporcion me peshën e veprës konkrete penale, rrethanave të kryerjes si dhe personalitetit e të pandehurit, dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës speciale që i akuzuari në të ardhmen të mos kryejë vepra penale, si dhe në kuptim të preventivës së përgjithshme të parandalimit të përgjithshëm të kësaj vepre penale në shoqëri shoqëri konform nenit 41 të KPRK-së.

Konformë nenit 463 parag.1 lidhur me par 3.të KPPK-së, të dëmtuarën përfaqësuesi i DBPZHR—Ferizaj, për realizimin e kërkeses pasuroro-juridike e ka udhëzuar në kontest civil, pasi i akuzuari e ka kontestuar vlerën e dëmit të shkaktuar si jo reale e përshkruar në dispozitiv të aktakuzës.

Vendimi mbi paushallin gjyqësor është marrë konform nen. 450 dhe 451 të KPPK-së, dhe Gjykata e ka obliguar të pandehurin që të paguaj paushallin gjyqësore në shumën prej 20 €, në afat prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbartimit me dhunë.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ


P.nr.1490/2015 me datë 08.08.2017

Procesmbajtës-praktikant

Kushtrim Marevei

Gjyqtari

Adem Shabani



KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mundë të ushtrohet ankesë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.